

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin që ka
përfunduar më 31 Dhjetor 2014**

RAPORTET I AUDITORIT TË PAVARUR

PËRMBAJTJA	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1
PASQYRA E POZICIONIT TË KOMPANISË	2
PASQYRA E TË HYRAVE GJITHPËRFSHIRËSE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE EKUITET	4
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	5
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE	6 - 24

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin dhe aksionarët e ELSIG SH.A.

Ne kemi qenë të angazhuar për auditimin e pasqyrave financiare shoqëruese të kompanisë së sigurimeve 'ELSIG' (më tej referuar si "Kompania"), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2014, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2014, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare që janë të lira nga materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit dhe bërjen e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në kryerjen e auditimit. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe planifikojmë e kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga ndonjë gabim material.

Auditimi përfshinë procedurat e kryerjes për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen në gjykimin e auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë mashtrim ose gabim. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të riskut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të Kompanisë në mënyrë që të dizajnojnë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga Menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Kompanisë paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2014 dhe performansën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.
Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2014

	Shënim	Më 31 Dhjetor 2014 (në Euro)	Më 31 Dhjetor 2013 (në Euro)
ASETET			
Paraja në dorë dhe në bankë	6	1,088,943	763,733
Investimet ne depozita	7	8,507,734	7,473,727
Pjesa e risiguruesit për detyrimet e sigurimeve		246,437	203,760
Kostot e përvetësuar të shtyra	8	749,288	1,355,239
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet		779,543	764,525
Asetet e tjera	9	587,803	614,810
Prona dhe pajisjet	10	264,255	167,112
Asetet e paprekshme	11	6,495	6,495
GJITHSEJ ASETET		12,230,498	11,349,401
DETYRIMET			
Humbjet dhe shpenzimet e korigjimit të humbjes (rezervat teknike)	12	3,673,135	3,077,792
Primet e pa fituara	13	3,657,310	3,169,270
Llogaritë e pagueshme të sigurimit	14	390,288	342,395
Llogaritë e tjera te pagueshme	15	395,801	229,456
GJITHSEJ DETYRIMET		8,116,534	6,818,913
KAPITALI AKSIONAR			
Kapitali aksionar	16	4,333,080	4,333,080
Fitimi i akumuluar		(219,116)	197,408
GJITHSEJ KAPITALI AKSIONAR		4,113,964	4,530,488
GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI		12,230,498	11,349,401

Autorizuar nga menaxhmenti për botim dhe nënshkruar më 27 Shkurt 2015.

Rexhep Idrizaj

Drejtör Gjeneral

Valon Berisha

Drejtör Financiar

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.